

URDHËR
Nr. 252, datë 24.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”, në nenet 22 e vijuese të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; në ligjin nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2021, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si vijon:

- a) realizimin e procedurave të prokurimit publik me fonde buxhetore të institucionit;
- b) dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme jashtë qendrës së punës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në largësi mbi 100 km, si dhe me shërbim jashtë vendit;
- c) nënshkrimin e kontratave administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 1089, datë 3.11.2025, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Ferit Hoxha